

Jahja DRANÇOLLI

Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Filozofik

Departamenti i Historisë

Email: jahja.drancolli@uni-pr.edu

ORCID: 0009-0004-1734-3947

KUD: 904:94(496.5-2)(05)

SHASI, NJË QENDËR E NJOHUR MESJETARE**Abstrakt:**

Shasi (Suacium, Svaç, Soacia etj.) është një nga qendrat mesjetare më të rëndësishme të hapësirës së Ulqinit dhe pellgut Shkodran, me një histori të gjatë banimi që nis nga antikiteti ilir dhe vijon gjatë periudhës romake, bizantine dhe mesjetare. Rrënojat e qytetit ndodhen rreth 25 km në verilindje të Ulqinit, përgjatë rrugës historike Tivar–Shkodër, në një pozicion strategjik mbi një kodër pranë Liqenit të Shasit. Zhvillimi urban i qytetit është përshtatur ngushtë me konfiguracionin e terrenit dhe përfshin Qytetin e Epërm (fortifikatën) dhe Qytetin e Poshtëm. Burimet historike e përmendin Shasin në dokumente zyrtare që nga viti 1089, ndërsa ipeshkvia e tij përmendet të paktën që nga shekulli VIII. Qyteti ishte pjesë e rëndësishme e organizimit kishtar të rajonit dhe, së bashku me Tivarin dhe Ulqinin, përfshihej në juridiksionin e mitropolisë së Durrësit. Gërmimet arkeologjike, veçanërisht ato të realizuara në vitin 1989, kanë dëshmuar një kontinuitet të gjatë kulturor, duke nxjerrë në dritë shtresa banimi që nga periudha ilire, romake dhe bizantine, deri në Mesjetë. Zbulimi i një shtrese kulturore të shekullit VI mbështet hipotezën se fortifikimet veriore të qytetit janë ndërtuar ose rindërtuar gjatë kohës së perandorit Justinian. Fortifikata e Shasit përfshinte një sipërfaqe prej rreth 2 hektarësh dhe ishte e rrethuar me mure dhe kulla mbrojtëse, të ndërtuara në përputhje me terrenin natyror. Qasja kryesore në qytet realizohej nga ana veriore, ndërsa ana jugore ishte e mbrojtur nga natyra shkëmbore. Brenda mureve janë ruajtur gjurmë të godinave të banimit dhe objekteve të kultit, ndërsa jashtë tyre janë identifikuar lagje dhe rrënojat e disa kishave. Një vend qendror në strukturën urbane dhe fetare të Shasit zë katedralja e Shën Gjon Pagëzuesit, selia ipeshkvnore e qytetit. Kjo ndërtesë paraqet veçori arkitekturore të rëndësishme, si integrimi i apsidës në katin përdhes të një

kulle më të hershme, si dhe ndarja funksionale e hapësirës së brendshme. Për nga stili dhe monumentaliteti, katedralja lidhet me traditën arkitekturore mesjetare të rajonit dhe gjen analogji me monumente të rëndësishme të Ballkanit Perëndimor. Shasi përjetoi periudha shkatërrimi dhe rimëkëmbjeje, duke u plaçkitur nga mongolët në vitin 1242 dhe më pas duke hyrë në një fazë të shpejtë rënieje nga fundi i shekullit XIV. Pas pushtimit osman të vitit 1571, qyteti humbi funksionin e tij urban dhe u shndërrua në një vendbanim rural. Megjithatë, rrënojat dhe të dhënat arkeologjike e bëjnë Shasin një dëshmi të rëndësishme për zhvillimin historik, fetar dhe urban të Mesjetës në këtë pjesë të Adriatikut lindor.

Fjalë kyçe: Fortifikata e Shasit, Katedralja e Shën Gjon Pagëzorit, Ipeshkvia e Shasit, Gërmimet arkeologjike në kala.

Abstract:

Shas (also known in historical sources as Suacium, Svač, Soacia, among other variants) represents one of the most significant medieval centers in the wider region of Ulcinj and the Lake Shkodra basin. The site demonstrates a long continuity of settlement beginning in Illyrian antiquity and extending through the Roman, Byzantine, and medieval periods. The ruins of the city are located approximately 25 km northeast of Ulcinj, along the historic Bar–Shkodra route, occupying a strategic hilltop position overlooking Lake Shas. The urban layout closely follows the natural configuration of the terrain and is divided into the Upper Town (fortress) and the Lower Town, a characteristic feature of many medieval settlements in the region. Historical sources mention Shas in official documents as early as 1089, while its bishopric is attested at least from the eighth century. Together with Bar and Ulcinj, Shas formed part of the ecclesiastical organization of the region and belonged to the jurisdiction of the Metropolitanate of Durrës. Archaeological investigations, particularly those conducted in 1989, have confirmed a long cultural and settlement continuity, revealing material remains from the Illyrian, Roman, Byzantine, and medieval periods. The discovery of a cultural layer dating to the sixth century supports the hypothesis that the northern fortification walls were constructed or reconstructed during the reign of Emperor Justinian. The fortress of Shas covered an area of approximately two hectares and was enclosed by defensive walls and towers adapted to the natural terrain. Access to the city was primarily from the northern side, while the southern

side was naturally protected by steep and rocky ground. Within the fortification walls, the remains of residential buildings and religious structures have been identified, while outside the walls traces of suburban areas and several churches have been documented. A central place in the urban and ecclesiastical structure of Shas was occupied by the Cathedral of Saint John the Baptist, which served as the episcopal seat of the city. This monument displays significant architectural features, including the integration of the church's apse into the ground floor of an earlier tower and the functional division of the interior space. In terms of style and monumentality, the cathedral reflects the broader medieval architectural tradition of the western Balkans and shows affinities with important ecclesiastical monuments in the region. Throughout its history, Shas experienced cycles of destruction and recovery. The city was plundered by the Mongols in 1242 but subsequently recovered and continued to function as an urban and ecclesiastical center. From the late fourteenth century onward, however, it entered a period of rapid decline. Following the Ottoman conquest in 1571, Shas lost its urban character and was gradually transformed into a rural settlement. Nevertheless, the surviving ruins and archaeological evidence make Shas an important case study for understanding the historical, religious, and urban development of medieval settlements in the eastern Adriatic hinterland.

Keywords: Shas Fortification, Cathedral of Saint John the Baptist, Bishopric of Shas, Archaeological excavations in the castle.

Hyrje

Suacium, ose Shas, ose Svaç, një qytet-rrënojë e fortifikuar 25 km në veriperëndim të Ulqinit në rrugën Tivar-Shkodër. Qyteti u ndërtua në anën perëndimore të famullisë së Oblikut, që korrespondon me luginën e sotme të Anamalit, që ishte një zonë bujqësore e Shasit në kohët e lashta.¹ Ndonjë

¹ *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, vol. I: collegerunt et digesserunt Ludovicus de Thallóczy, Constantinus Jireček, et Emilianus de Sufflay, Vindobonae, 1913, No. 63, 68, 554, p. 17; M. Shuffaj, *Qytetet dhe kështjellat e Shqipërisë: Kryesisht në mesjetë*, Tiranë: Onufri, ed. L. Malltezi, 2009, pp. 11, 33,49, 51, 77, 79. 82, 84, 99, 101, 109, 110, 131, 139, 150, 151; James Pettifer and Averil Cameron. *The enigma of Montenegrin history. The example of Svač*: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgglefindmkaj/https://www.professorjamespettifer.com/uploads/files/pdf/The%20enigma%20of%20montenegrin%20

studiuës fillimet e qytetit i ndërlidhë me periudhën e ndërtimeve të Justinianit (527-565), një perandor bizantin me origjinë dardane. Qyteti në fjalë sikur edhe disa qytete të tjera përreth tij është ndërtuar duke e ndjekur konfiguracionin e terrenit. Së këtejmi, në pjesën shkëmbore është ndërtuar Qyteti i Epërm apo Kalaja (Fortifikata), ndërkaq më poshtë kalasë ndeshim në gërmadha të Qytetit të Poshtëm. Që të dy këto pjesë të qytetit të Shasit me kohë tërhuqën vëmendjen e kronistëve, udhëpërshkruesve dhe studiuesve ballkanas dhe evropianë.

Rezultatet e deritanishme për kalanë

Rrënojat e qytetit të epërm ose të fortifikatës shtrihen mbi kuroren e një kodre, nga larg thuhet të padallueshme, po të mos ishin ende gjysmë në këmbë gërmadhat perimetrale të një kishë. Ngjitja dhe endja nëpër gërmadhat e fortifikatës nuk është aspak e lehtë. Kudo kanë mbirë shkurre e bimë kacavjerrëse, në këtë vend nuk ka mbetur gur mbi gur, përveç mureve që ende qëndrojnë nga dy kisha dhe shtyllave anësore të njëres prej portave të qytetit. Për rrënojat e qytetit dhe të kishave të Shasit, njoftime të hollësishme ndeshim te Theodor Ippen të publikuara më 1899, 1900 dhe më 1902. Diplomati dhe studiuesi në fjalë, nga kapërcylli i shek. XIX kishte bërë rekognoscimin e qytetit të rrënuar të Shasit dhe kishte parë vetëm gërmadhat e qytetit, që vëreheshin mjaft mirë. Aty, në radhë të parë kishte vërejtur tarracën me rrënojën e kishës së ruajtur mirë dhe mbi to Qytetin e Epërm ose Kalanë. Nga poshtë janë parë rrënojat e murit rrethues të qytetit. Në mënyrë të veçantë këndi verilindor, i cili përbëhet nga një bastion i vogël, që ishte ruajtur deri në një lartësi prej dy bojë njeriu. Muri i qytetit që shihet nga liqeni kishte humbur tërësisht.²

history.pdf, access 12/06/2025; A. Degrand, *Souvenirs de la Haute-Albanie*, Paris, 1901, 100; Prof. dr. Jahja Drançolli, *Kalaja e Shasit*, in “*Shasi i lashtë, monument i kulturës*” (përmbledhje e kumtesave nga Sesioni shkencor i mbajtur më 16-17 maj 2008), OJQ “Ora”, Ulqin 2009, pp. 33-38; Autori i njejtë, *Në Shas janë zbuluar edhe shenjat e kulturës ilire*, in Buzulu, Ulqin: 2021, pp. 14-15; Savo Marković, Prošlost Svača: <https://montenegrina.net/proslost-svaca-u-zivotopisima-njegovih-crkvenih-dostojanstvenika-i-zitelja-savo-markovic/>, access, 29/03/2025; *Istorija Crne Gore. Knj. 1, Od najstarijih vremena do kraja XII vijeka*. Titograd: Redakcija za istoriju Crne Gore, 1967. p. 295, 324. V. Korać, *Graditeljska B. Kopaň, Graditeljska škola Pomorja*, Beograd, 1965, 58–65.

² M. Shuflaj, *Qytetet dhe kështjellat e Shqipërisë*, në më shumë vende.

Shasi (*Suacium*, *Sfacia*, *Soacia*, *Suvacium*, *Soaço*, *Suaço*, *Suazzo Svacinenses*, *Suacinenses*, *Soacienses*, *Svacienses*, *Svatinenses*) me këtë emër përmendet nga viti 1067 e deri më 1530. Gërmadhat e kalasë së Shasit shihen edhe sot sipër fshatit të vogël të Shasit që nga vendorët quhen “Kishat”.³ Janë të njohura monedhat e prera me emër të qytetit, ku në avers të monedhës paraqitet fytyra e Shën Gjonit Pagëzorit, mbrojtës i qytetit, dhe në anën tjetër paraqitet një pìrg me mbishkrim “*Sovaci civitas*”. Muri i këtij qyteti duket se formonte një katërkëndësh të ngushtë dhe të gjatë në drejtim të kurrizit të malit dhe përfshinte edhe të dy shpatullat e tij. Aty shihen dy porta, njëra sipër fshatit, tjetra te shpatulla e pjerrët e liqenit. Qyteti u plaçkit nga mongolët më 1242, por e mori veten sërish. Nga viti 1388 nisi dekadencia e shpejtë. Në vitin 1406 në kurriz të Bashkisë së qytetit të Shasit, Ulqini i zgjeroi rrethet e veta. Po në këtë vit (1406) muret e fortifikatës ishin në një gjendje të mjerueshme, sa që ipeshkvi i Shasit, si i dërguar i qytetit shkoi në Venedik për të kërkuar leje për rindërtimin e tyre, meqë turqit kishin nisur t’i plaçkisnin rrethet. Republika e Raguzës për këto qëllime më 1413 ofroi tjegulla për të mbuluar pullazin e një kishe.⁴ Shasi, më pastaj bëhet një proni e thjeshtë (1443), edhe pse ipeshkvia kishte mbijetuar ende.⁵ Ndërsa në vitin 1470, sipas dokumenteve venedikase zuri të quhet “*villa de Suazzo*” (fshati i Shasit).⁶ Në vitin 1553 *Giustiniani* shkruante se në Shas ruhen gërmadhat e 360 kishave, si dhe pjesë të kalasë së qytetit: “muret dhe porta e qytetit ishin ende, gjë që na çuditë veçanërisht”, madje edhe hendeku nuk ishte i mbushur me leth si në kala të tjera të kohës.⁷ Muret dhe dy porta të qytetit në rrënoja

³ M. Shufflay, *op. cit.*, në më shumë vende.

⁴ *AAV*, I/3, No. 1187: “...*propter Teucros et tira(m)pnos*”, J. Pettifer & A. Cameron, *op. cit.*, 17: “In the second half of the fourteenth century the Catholic dioceses were at their height and a “John of Suacio” lived in the household of the archbishop of Ragusa in 1365-71. The cathedral at Svač was repaired after damage in war in 1413. Again, local oral tradition is illuminating: the authors in 2004 found inhabitants of Ambula believing that “our real history is to be found in the Vatican”.

⁵ *AAV* I/3, p. 525, No. 1297; *AAV*, III/19, p. 196-197, No. No. 5241.

⁶ M. Shufflay, *Qytetet dhe kështjellat e Shqipërisë*, 25, 29; *AAV*, III/18, p. 27, No. 4813; *AAV*, III/19, p. 196-197, No. 5241.

⁷ *Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium. Commissiones et relations venetae*, tomus II, annorum 1525-1553, collegit et digessit Simeon Ljubić. 8, ZAGRABIAE 1877, p. 231: “In quella provincia fù una antichissima città detta Suazzi, le cui gran vestigie et le fundamenta di trecento sessanta capelle di chiesa si vedono oggidi lontane da Dulcigno miglia quindeci , et fù primo ricetta alla descaciata Medea dopo la scelarata morte commessa nei propri figliuoli. Vi sono appresso questa città laghi , caverne, fontane salse et il monte

i kishte parë edhe Ippen më 1899. Përveç këtyre shihen edhe rrënojat e disa kishave, si dhe gërmadhat e një kishe të madhe me altar në pìrg, dhe të një kishe tjetër me mbetje të afreskave dhe me varrin e një ipeshkvi të quajtur Mark, i vdekur në vitin 1262.

Turqit e pushtuan më 1571 dhe ia shkatërruan muret rrethuese dhe godinat në të. Për të shkruan argjipeshkvi i Tivarit *Marin Bizzi* më 1610: “Shasi, dikur qytet shumë i madh dhe i fortifikuar më së miri, sikurse edhe sot e tregojnë rrënimet e tija. Thuhet edhe se aty pati deri në 365 kisha, d.m.th. aq sa janë ditët e vitit. Tashti është shndërrue e ba fshat, ashtu siç ndodh zakonisht me pushtimet e turqve që çdo gja shkretojnë e rrënojnë [...]. Gjendet i vendosur mbi një kodër përsipri një liqeni të kandshëm, të gjanë e të mbushun me peshq të ndryshëm, me të cilët sidomos mbahen (rrojnë) ata banorë [...]. Është rreth 20 mil larg prej Tivarit. Përballë, n’anë të detit, i qëndron qyteti i Ulqinit, që në luftën e kalueme ra në pushtimin e turqve bashkë me Tivarin, që ishin të republikës së Venedikut [...]. Ka kishën e shën Gjon Pagëzuesit, shumë të madhe, përveç shumë të tjerave që janë të zblueme [...]”⁸ Është për të vënë re se, *Marin Bizzi* e shfrytëzoi një leje të papatit duke vizituar të gjithë argjipeshkvinë e Tivarit duke shqyrtuar gjendjen e popullsisë dhe klerit katolik në vendet nën sundimin osman. Gjatë rrugës, ai vizitoi besimtarët e

Lisigna asprissimo et di venenose erbe copioso et di femine incantatrici abitazione. La muraglia di questa città et la porta, dove stave gran capitano di Cesare contra Pompejani virilmente combattendo morì, sono oggi tutte integre, et quel che più maraviglioso di questo è il fosso, che non è ancora agguagliato et tant’aque di torrenti et pioze da tanto tempo addietro non l’hanno possuto empier di terreno.” (“Në atë provincë kishte një qytet shumë të lashtë të quajtur Suazzi, mbetjet e mëdha të të cilit dhe themelet e treqind e gjashtëdhjetë kishave kishtarë janë tani pesëmbëdhjetë milje larg Dulcigno, dhe ishte streha e parë e Medeas së mërguar pas vdekjes së ligë të kryer mbi fëmijët e saj. Pranë këtij qyteti ka liqene, shpella, burime kripe dhe mali Lisigna, shumë i ashpër dhe plot bimë helmuese dhe shtëpi e grave magjepsëse. Muret e këtij qyteti dhe porta, ku kapiteni i madh i Cezarit qëndroi dhe vdiq duke luftuar me trimëri kundër pompeianëve, sot janë të gjitha të paprekura, dhe ajo që është më e mrekullueshme nga të gjitha është hendeku, i cili ende nuk është niveluar dhe që kaq shumë përrenj dhe shira nuk mund ta mbushnin me tokë për një kohë kaq të gjatë.”

⁸ J. Pettifer & A. Cameron, *The enigma of Montenegrin History*, pp. 3-4: “Svač fortress, the ruins of a medieval town above Saska Lake not far from Ulcinje. The date of its construction is not known. Pope Alexander II mentioned the town in a bull dated 1067 when Svač was an Episcopal seat. Shattered by the Mongols in 1242, Serbian Queen Helen of Anjou had it rebuilt in the late 13th century. In the 15th century the Venetians seized the fortress, and in 1571 it fell to the Turks. Svač went into a decline in the early 15th century [...]. By 1610 the town had been destroyed [...], in the 17th century it lay in ruins, abandoned to the elements.”

tij katolikë në vendet nga Shasi në Prokuplje te lumi Toplicë. Gjatë kthimit nga Prokuplja nëpërmjet Trepçës, Novi Pazarit, Prijepoljes dhe Pljevljes, ai mbërriti në Trebinjë, prej andej në Konavle, pastaj në Kotorr dhe në fund në Budvë. Në 1611, ai vizitoi përsëri Tivarin, por shpejt u desh të kthehej sepse osmanët po punonin për kokën e tij. Jo shumë kohë më vonë, Bizzi udhëtoi për në ishullin Rab dhe në 1612 mbërriti në Romë. Raporti i gjerë *Relazione della visita fatta da me Marino Bizzi, Arcivescovo d'Antivari, nelle parti della Turchia, Antivari, Albania e Servia alla Santità di Nostro Signore Papa Paolo Quinto* përmban një përshkrim të vizitës në Kryedioqezën e Tivarit, duke u bërë një burim i dobishëm historik për njohjen e vendeve ballkanike gjatë sundimit osman. Raporti mbulonte zonën nga Budva, Tivari dhe Durrësi në verilindje deri në lumin Morava dhe ai ia dorëzoi Papa Palit V. Bizzi qëndroi në Romë deri në vdekjen e tij. Raporti i tij ndodhet në bibliotekën e princave Barberini në Romë me titullin *De Albania, Servia et Antibarensi provincia relatio Marini Bizzi, antibarensis archiepiscopi*, që më vonë u botua nga historiani kroat Franjo Rački. Vizita përmban disa vëzhgime interesante në lidhje me monumentet, por sigurisht lajmi më i rëndësishëm për historinë e arkeologjisë shqiptare është zbulimi i disa copave të monedhave ari. Bizzi shprehet se pas vizitës së kishës së Shën Aleksit në qytetin e Kukësit, të cilën ai e përshkruan me hollësi (vetë vendi quhet Cocus), ka vizituar rrënojat në të cilat osmanët gjetën njëzet monedha ari, jo medalje, sepse në shkrimet dhe literaturën e asaj kohe fjala medalje përdorej për para, dhe jo për medalje, ndoshta në kuptimin e vjetër të monedhës, dhe ky është lajmi më i vjetër për gjetjet e metaleve të çmuara në ato zona.⁹

⁹ Franjo Racki, *Izveštaj barskoga nadbiskupa Marina Bizzia o svojem putovanju god. 1610 po Arbanaškoj i Staroj Srbiji*, in: *Starine, Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti*, Zagreb, 20 (1888), pp. 50-156; Cfr. Injac Zamputi (ed.): *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë veriore dhe të mesme në shekullin XVII*. vol. 1 (1610-1634), Tiranë 1963, pp. 48-241. Përkthim i Robert Elsie. *First published in R. Elsie: Early Albania, a Reader of Historical Texts, 11th - 17th Centuries*, Wiesbaden 2003, pp. 77-129.

Rrënojat dhe katedralja e Gjon Pagëzorit në Kala¹⁰

Një çështje, të cilën e veçonte nga surveu i tij, ishin objektet e kultit, përkatësisht kishat e Shasit, pjesë këto që i përkisnin ipeshkvisë së qytetit. Është e njohur se Ipeshkvia e Shasit ka zotëruar territor tejet të ngushtë, që është kufizuar nga perëndimi me Tivarin, nga veriu me Shkodrën, dhe nga jugu me Ulqinin. Në dokumente mesjetare ipeshkvi i Shasit përmendet me emra: *Suacium*, *Sfacia*, *Soacia*, *Suacium*, it. *Soaço*, *Suaço*, *Suazzo Svacinenses*, *Suacinenses*, *Soacienses*, *Svacienses*, *Svatinenses*. Duke iu referuar gjithnjë Ippen-it, mbi Qytetin e Epërm apo Kalanë qëndronte lart kisha me pìrg. Kisha në fjalë zotëronte një sallë kënddrejtë; mbi altar ishte ngritur pìrgu i kambanores. Pozita e pìrgut në këtë kishë ndryshonte nga kishat e tjera, ku ai është gjendur zakonisht në anën ballore. Nga kisha ishin ruajtur vetëm katër mure. Pjesa e brendshme ishte mbushur me rrënoja dhe baroje të mbira midis tyre. Megjithatë, mund të vëreheshin salla dhe narteksi. Kjo kishë, shihet nga një largësi si pika më e dallueshme e rrënojave të qytetit. Nga rrënojat e kishave të tjera, që ndodheshin mbi tarracën, e cila shtrihet jashtë murit rrethues pranë shpatit lindor të kodrës, Ippen-i kishte veçuar fasadën ballore të një kishe që ishte ruajtur më mirë. Kjo fasadë zotëronte një portë të punuar me kujdes, të mbuluar me një hark rrethor dhe një dritare të ngushtë mbi të. Dy kisha të tjera rrënojë, që ndodheshin jo aq larg nga kisha që u përmend më sipër ishin ndërtime të thjeshta. Ndërkaq, nga një kishë e katërt, Ippen-i kishte parë vetëm pak gjurmë muresh mbi sipërfaqe të tokës.¹¹

¹⁰ J. Pettifer & A. Cameron, op. cit., 17; K. Jiriček, *Albanien in der Vergangenheit*, in: L. von Thallóczy, ed., *Illyrische-Albanische Forschungen*, 2 vols. (Vienna, 1916), I, 63-93, në veçanti p. 83: "By the early fifteenth century Svač was petitioning Venice to fortify the town against the Turks; for the settlement of uncertainty about the extent of its territory; the bishop of Shkodra was to be consulted. A little later the bishop of Svač was praised and had land restored to him in recognition of his good Catholic behavior. By the late fifteenth century, when most of Albania was under Ottoman control, Venice held Bar and Kotor and Catholicism was firmly established along the coast. However, by the 1460s the bishops of Svač were absentees living in Italy and Venice was able to give away the town as *pronoia*. Already in the late fourteenth century Pilot, Shkodra and Sarda were described as being very poor, and by the late fifteenth century Svač, Sarda and Drisht all lay in ruins"

¹¹ J. Pettifer & A. Cameron, *The enigma of Montenegrin History*, p. 4; E. Zečević, Rezultati istraživanja srednjovekovnog Svača, in: Glasnik Srpskog Arheološkog Društva, No. 5, 1989, pp. 112-114; P. Mijović-M. Kovačević, *Gradovi, tvrđave u Crnoj Gori*, Beograd-Ulcinj, 1975, 131.

Njoftimet që u zunë në gojë më sipër shpijnë të konstatohet se është fjala për katedralen e Shasit kushtuar Shën Gjonit Pagëzorit, seli kjo ipeshkvnore e ndërtuar mu në afërsi të portës kryesore të kalasë. Në anën më të gjatë të saj është vendosur në drejtim perëndim-lindje. Terreni ku është ndërtuar katedralja shkon nga verilindja në drejtim të jugperëndimit. Themelet e godinës janë projektuar në trajtën kënddrejtë të zgjatur, me apsidë gjysmërrethore të kthyer nga ana lindore. Gjatë realizimit baza është deformuar, sipas gjitha gjasave nga terreni i papërshtatshëm, kështu që muret bartëse krijojnë një romboid në projektion horizontal. Masat e brendshme kanë një shtrirje të përafërt prej 6.5/15.80 m (diagonalët 16.50 dhe 17.80 m). Apsida ruan një distancë prej 2.90. Mbi apsidë është ngritur një kullë nga e cila është ruajtur kati përdhe dhe kati i parë. Kulla është më e vjetër se kisha katedrale, ndërkaq apsidja është ndërtuar në katin përdhe të kullës. Lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet kullës dhe kishës është realizuar nëpërmes dyerve të vendosura në mes të murit të apsidës. Zgjedhja e jashtëzakonshme e realizuar me vendosjen e pjesës së altarit të kishës të nxjerrë ca më jashtë në katin përdhe të kullës ka qenë gjithsesi i vendosur nga nevoja për të shfrytëzuar më racionalisht hapësirën e kalasë. Naosi i katedrales ka qenë i ndarë me mur të tërthortë në dy pjesë.

Kisha është ndërtuar nga guri i latuar mirë në katrore, me taban dhe pilastra të cekta në anën perëndimore, muri i rindërtuar nuk ka qenë i lidhur konstruktivisht me mure anësore. Duke gjykuar nga gjurmët e llaçit të mbetur në mure të kishës, ruante një gjatësi prej 1 m. Në mes të murit është ndërprerë me qëllim të krijonte hyrje për lëvizje ndërmjet dy pjesëve të kishës. Është më se e qartë se në lindje prej murit lindor është gjendur kori, pjesa prezviteriane e kishës, ndërkaq në perëndim hapësira për besimtarët. Muri i tërthortë paraqiste zdatkun e ulët të korit. Edhe pse pjesa e brendshme e ngrehinës është mbuluar me rrënojë, mund të konstatohet se dysHEMEJA në pjesën lindore të kishës ka qenë ca më i lartë se i pjesës perëndimore. Për këtë arsye ka të ngjarë se në vrimën e zdatkut të murit ruhen 2-3 shkallë. Për nga stili dhe monumentaliteti, katedralja e Shën Gjonit në Shas ruan elemente të cilat mund të ndeshen edhe në kishën sase në Novobërdë, kishën e Shën Franit në Kotorr, manastirin e Deçanit, Patrikanën e Pejës, Shën Nikollës në Ston afër Dubrovnikut, kishave françeskane në Ulqin, Tivar Shkodër, Sardë,¹² etj.

¹² V. Korać, Graditeljska škola Pomorja, Beograd, 1965, 58-65; Jahja Drançolli, Raguzanët në Kosovës, Prishtinë: Instituti i Historisë, 1986, në më shumë vende.

Ipeshkvia e Shasit

Si ipeshkvi Shasi (Suacium) përmendet qysh në shekullin VIII dhe së bashku me Tivarin dhe Ulqinin ishin pjesë përbërëse e Themës së Durrësit. Treva e Shasit, Ulqinit dhe Tivarit në kohën e themelimit të mitropolisë së Shkodrës, më 535 i përkisnin juridiksionit të argjipeshkvisë, Justiniana Prima. Ipeshkvia e Shasit, së bashku me ipeshkvinë e Tivarit dhe Ulqinit, përmendet edhe në regjistrin e sufraganëve të mitropolisë së Durrësit nga kapërcyelli i shek. IX apo fillimi i shek. X. Autorët e “Ilyricum Sacrum” theksojnë se nuk kanë gjetur asnjë ipeshkëv të Shasit para shekullit të X, “Harresa ka shkatërruar emrat dhe bëmat e paraardhësve të asaj kohe”. Dy ipeshkëv të panjohur të Shasit përmenden gjatë shekujve IX-X, ndërsa i treti përmendet në Kronikën e Tomë Arkigjakonit, ku thuhet se ai vdiq në një mbytje anijeje afër Hvarit, kur po udhëtonte me det për në Split për një sinod, rreth vitit 1050. Bazili së bashku me ipeshkvin e Ulqinit e ndihmuan në shugurimin e ipeshkvit të parë të Hvarit.

Ipeshkvi Pjetër në vitin 1166 e përmend si të pranishëm në shenjtërimin e Katedrales së Kotorrit. Dominiku, 1199-1200, mori pjesë në Koncilin e Dukljes në vitin 1199, kur shumë nga klerikët dhe njerëzit e qytetit të Sasit e akuzuan për vrasje. Një ipeshkëv Peshkopi i Shasit përmendet në një letër të Papa Inocent III nga viti 1200 drejtuar Gjonit, Argjipeshkëv i Tivarit. Ai u zgjodh për të zëvendësuar Dominikun e rrëzuar, i cili e kishte provuar veten të padenjë për të qeverisur Kishën e Shasit. Ipeshkvi i panjohur i Shën Stefanit, 1250/51 në një letër nga Inocenti IV i Lionit, në vitin 1250, ipeshkvet, përfshirë ipeshkvin e Shasit, urdhërohen të bëjnë çdo përpjekje për t'i kthyer mallrat e shkatërruara dhe të vjedhura në Kishën e Tivarit. Ipeshkvi Marcus lidhet me kohën para vitit 1262. Në vitin 1284, Petrus ishte i pranishëm në manastirin e Shën Pjetrit gjatë një mosmarrëveshjeje midis Argjipeshkvit të Tivarit dhe ipeshkvit të Kotorrit ishte i pranishëm në kuvendin e Shën Spasit në Tivar. Një mbishkrim në një gur varri nga Shasi i referohet atij. Ndërsa, pas vitit 1317 një ipeshkëv i Shasit i quajtur Benedikti/Benedetto (1307-1317) do të shpallet argjipeshkëv i Raguzës.¹³ Pas Benediktit përmendën edhe disa ipeshkëv të tjerë të Shasit: Minori 1403-1404, i emëruar në vitin 1404 argjipe-

¹³ M. Shuffaj, *op. cit.*, në më shumë vende; AAV; II/12, p. 17, No. 2859. *Istorija Crne Gore*, I, p. 324; <https://montenegrina.net/proslost-svaca-u-zivotopisima-njegovih-crkvenih-dostojanstvenika-i-zitelja-savo-markovic/access:29/03/2025>; [https://www.catholic-hierarchy.org/diocese/ds598.html/ccess 14/06/2025](https://www.catholic-hierarchy.org/diocese/ds598.html/ccess%2014/06/2025).

shkëv i Durrësit; Pjetër Kirteni i emëruar për ipeshkëv i Shasit më 27 shkurt 1404; Antoni da Firenze i emëruar më 12 gusht 1418; Pjetri i emëruar në vitet 1420-1435, dhe për t'u emëruar në vitin 1435 ipeshkëv i Ulqinit; Sergji, i emëruar në vitin 1439-1440; Pal Dusa i emëruar në vitet 1440-1445; Antonio de Fabriano (1446-1465); Ishtvani në vitin 1507; Nikolla, në vitin 1517; Giovanni de Rosa (1520-1524), si dhe Toma në vitin 1530.¹⁴

Pas përmbysjeve të ndryshme të cilave Shasi iu nënshtrova së bashku me kishat e tjera në këtë regjion, ajo mbeti një dioqezë sufragane, "satelite" e dioqezës së Tivarit. Biografia e Nemanjës nga viti 1216 thotë se Shasi u shkatërrua, ashtu si edhe qytetet fqinje. Më 1244 shkatërrohet nga tartarët. Por e merr veten sërish, nis e pret madje edhe monedhat e veta. Monedha e bakrit e Shasit, me mbishkrimin "Sovacii civitas", paraqiste një kështjellë trekatëshe, ndërsa në anën tjetër ishte një paraqitje e shenjtorit mbrojtës të qytetit, Shën Gjon Pagëzorit. Ndërtesat më të rëndësishme në qytet janë katedralja me të njëjtin emër nga viti 1300, e cila kishte një kabanë, të ndërtuar mbi themelet e një kisha të hershme bizantine ose të shekullit të 11-të, si dhe kisha e Shën Mërisë (shek. XIV), gjithashtu me themele më të vjetra. Me rënien e komunës, ipeshkvi mori përsipër kujdesin për komunitetin e mbetur, i cili në vitin 1406 ishte përfaqësuesi i saj në Venedik. Megjithatë, ai nuk mundi të parandalonte shndërrimin e Shasit në një pasuri feudale. Kështu, në vitet 1440, Shasi ra në duart e mbështetësve venedikas nga Tivari. Është përmendur si fshat në vitin 1443, kurse në vitin 1470 ishte "communitas" i njohur tashmë si "villam seu locum Suacij". Pas rënies në duart e osmanëve në vitin 1571, qyteti u shkatërrua. Janë ruajtur pjesë të mureve, gjurmë ndërtesash dhe dy porta të qytetit. Njihen tetë kisha; Përveç atyre të përmendura tashmë, të tjerat datojnë nga shekujt XI-XIV. Disa prej tyre me siguri iu kushtuan Shën Dhimitrit dhe Shën Hieronimit.¹⁵

Rënia duhet të ketë filluar me ngritjen e princërve të Arbërisë, konkretisht në ato anë të Balshajve. Sikurse e kanë vënë re K. Jireçek dhe M. Shufflay. Aty nga fundi i shekullit 14 plaçkitet nga ana e turqve. Kur venedikasit arrijnë të mposhtin, Gjergjin III Balsha në vitin 1420/21, Shasi kishte përdorur si qytet fortifikatë dhe ishte shndërruar në një proni të thjeshtë. Në një vështrim të parë qyteti duket se ka qenë i mirë fortifikuar e i mbrojtur nga pozita e tij e ngritur. Por pastaj e kupton se ndryshe nga Rozafa ose fortifikata e Drish-

¹⁴ <https://www.catholic-hierarchy.org/diocese/ds598.html>/ccess 14/06/2025.

¹⁵ <https://montenegrina.net/proslost-svaca-u-zivotopisima-njegovih-crkvenih-dostojanstvenika-i-zitelja-savo-markovic/access:29/03/2025>.

tit, pozicioni nuk është ai i një kalaje në vend të thepisur që do e mund t'i bënte ballë një rrethimi të gjatë. Vetë kjo kodër është e butë dhe ndodhja e saj pranë ujërave jetëdhënëse të Bunës e liqenit dhe anë rrugës që lidhte pellgun shkodran me bregdetin, aq sa ishin kushte të mira për një lulëzim paqësor. Është për të vënë re se, njoftimet e deritanishme për fortifikata rreth Shkodrës kanë shumë boshllëqe. Këto boshllëqe pamundësojnë edhe njohjen e mirë të lashtësisë së Shasit. Dihet se kalaja në fjalë është gjendur mbi një varg kodrinash shkëmbore të thata prapa nyjës së madhe malore të Lindjes, përkatësisht në anën e majtë të shtratit të lumit Megjureç, i cili është kthye në një liqe, të quajtur, Liqeni i Shasit.¹⁶

Gërmimet arkeologjike në kala

Sipas rezultateve nga gërmimet sondazhi të deritanishme, janë vërejtur disa faza ndërtimi të qytetit. Muret rrethuese të shoqëruara me kulla e rrethonin kodrën që përfshinte një sipërfaqe prej afro 2 ha. Duke ndjekur terrenin muret rrethuese krijonin një hapësirë kënddrejtë jo të rregullt, e cila përfshinte një gjatësi prej 230 m, që çonte në drejtim lindje-perëndim dhe gjerësi prej 58 m në drejtim veri-jug. Nga veriu, perëndimi dhe lindja fortifikata ka qenë e rrethuar me mure dhe kulla mbrojtëse. Ndërkaq, kah jugu natyra e bënte të paarrtshme. Edhe pse terreni ishte i rrëpinët dhe shkëmbor, ka ekzistuar një shteg i cili të shpinte deri tek uji, dhe përgjatë të cilit janë ruajtur gjurmë të mureve dhe të dyerve. Fortifikata kishte qasje vetëm nga ana veriore nëpërmes hyrjes që gjendet në mes, pjesë e cila është mbrojtur edhe nga një mur tjetër sekondar. Fortifikata nga pjesa veriore ka përcjellë mirë shkëmbin. Muri rrethues perëndimor dhe lindor me kulla katërkëndëshe është ruajtur më mirë. Ndërkaq, nga muri jugor kanë mbetur vetëm gjurmët e murit dhe të kullës, që mbizotëronte pjesën me shikim nga liqeni. Gjithashtu janë vërejtur shumë rrënoja brenda dhe jashtë mureve rrethuese të qytetit. Brenda qytet ruhen rrënojat e godinave të banimit. Ndonjë nga këto janë ruajtur mirë, sa që në shikim të parë mund të mendosh se është fjala për ndonjë godinë jo të moçme.¹⁷

Sipas gjetjeve nga gërmim sondazhi në fjalë, me ç'rast në qytetin e epërm të Shasit është zbuluar edhe një shtresë kulturore nga shek. VI, mund të supo-

¹⁶ *Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV*. Edited by Joseph Valentini, S.J. Pars I: *Saeculum XIV complectens*, Tomus I-3, No. 1187, p. 524, 525; III, No. 4813, 5241, pp. 27, 196, 197.

¹⁷ Prof. dr. Jahja Drançolli, *Në Shas janë zbuluar edhe shenjat e kulturës ilire*, p. 15.

zohet se, muret veriore të qytetit janë ndërtuar (apo rindërtuar) gjatë periudhës së perandorit Justinian. Në veri nga fortifikata ruhen gjurmët e lagjes jashtë fortifikate, si dhe rrënojat e 8 kishave. Më e madhja ishte ajo kushtuar Zonjës Mëri, e cila është ngritur rreth vitit 1300 në veriperëndim të kalasë. Në afërsi të kishës së Zonjës Mëri është zbuluar edhe material i pasur i qeramikës nga periudha e hershme mesjetare. Me këtë periudhë mund të ndërlidhet edhe ndërtimi i portës veriore dhe jugore të qytetit.¹⁸

Përveç gjetjeve që u përmendën më sipër, në arealin e qytetit janë zbuluar edhe shumë fragmente qeramike nga periudha e neolitit të hershëm, eneoliti dhe bronzi, por më evidente janë gjetjet e kulturës ilire nga periudha e hekurit. Ndërkaq, disa fragmente të gjetura të qeramikës helene shpijnë të supozohet se shtresa helene ka mundur të ekzistonte mu në afërsi të pjesës veriore të qytetit. Fragmente të qeramikës së kuqe dhe të verdhë romake, janë zbuluar në pjesën e qytetit të epërm. Kjo vertikale e gjatë historike e kulturës materiale të Shasit vazhdonte të jetonte edhe gjatë gjithë shekujve të mesjetës.


Përfundime

Shasi mesjetar me kontinuitet të antikitetit zë një pozicion dominues në kodrën midis liqenit të Shasit në jug dhe fushës pjellore të deltës së Bunës në veri, e vendosur në udhëkryqin midis Shkodrës dhe Tivarit, Shkodrës dhe Ulqinit, qytete të rëndësishme mesjetare. Qyteti përbëhej nga tre njësi: 1. Qyteti i Sipërm, i ndërtuar në vetë shkëmbinjtë e kodrës mbi liqen, i fortifikuar mirë me mure dhe kulla, që të çonte në portën kryesore të qytetit që ndodhej në mes të mureve veriore, ku hyrja në qytet ishte e mundur për shkak të pjerrësisë së butë. 2. Nënkalaja u zhvillua në këtë shpat të butë dhe supozohet se ishte i fortifikuar edhe me ledhe. 3. Porta më e vogël, jugore e qytetit, të çonte në pjesën jugore të qytetit, e cila zbriste pjerrtas drejt liqenit të Shasit. Kisha më e rëndësishme e qytetit iu kushtua Shën Gjonit Pagëzorit, mbrojtësit të qytetit dhe siç dëshmon mbishkrimi i ruajtur në të, ajo u ndërtua në vitin 1300. Ndodhej në Qytetin e Epërm dhe rreth saj u formua një shesh, i cili së bashku me kishën përbënin qendrën e jetës publike të qytetit. Periferi, i cili kishte disa kisha, dominohej nga kisha romako-gotike e Virgjëreshës Mari. Të gjithë jetuan vazhdimisht nga shekujt VI deri në shekullin XVI. Krijimi i saj lidhet me kohën e perandorit Justinian dhe ndërtimin e një sërë fortifikimesh më të vogla që mbronin Shkodrën, një qendër e rëndësishme ushtar-

¹⁸ V. Korać, Graditeljska škola Pomorja, Beograd, 1965, 58-65.

ake, ekonomike dhe kulturore e rajonit. Shasi ishte qendër e njohur ipeshkv-nore qysh në shekullin e VIII. Ndërsa me emrin e tij Shas u përmend për herë në burimet historike në vitin 1089 në bulën e Papa Klimentit III. Përmendja relativisht e shpeshtë e qytetit në burimet historike të kësaj periudhe dëshmon për rëndësinë e tij në strukturën e shtetit të Dioklesë. Besohet se Shasi u bë pjesë e shtetit mesjetar nemanjid midis 1183-1186. Ai pësoi një shkatërrim të madh gjatë pushtimit mongol në 1242 dhe restaurimi i tij, i cili pasoi së shpejti, i atribuohet aktiviteteve ndërtimore të mbretëreshës Helena të Anzhuine në Bregdet. Në gjysmën e dytë të shekullit XIV, Shasi do të bëhet pjesë e shtetit të dinastisë arbërore Balshaj. Qyteti pësoi rënie, siç shihet nga letra e ipeshkvit të saj Pjetër Kirten drejtuar Republikës së Venedikut, i cili kërkonte ndihmë nga Signoria për fortifikimin e qytetit. Megjithatë, qyteti vazhdoi të bjerë, siç dëshmohet nga përmendja e Shasit si fshat në burimet e vitit 1470, dhe në vitin 1553 qyteti u shkretua plotësisht.

Shasi gëzonte autonomi në bazë të statutit të qytetit të lidhur me distriktin e tij, veçanërisht gjatë viteve 1406-1485. Në këtë kuadër përmendet edhe angazhimi i Pal Engjëllit në ruajtjen dhe afirmimin e distriktit të qytetit. Fakti që qyteti kishte një shkallë të caktuar autonomie dëshmon edhe prerja e parave qytet-bashki për nevojat e qytetit. Imazhi i monedhës përdorej në mënyrë aktive në paraqitjen e *“fytyrës së qytetit”*. Me fjalë të tjera, në ndërtimin e perceptimit të identitetit të saj, pasi u prenë dhe u hodhën në qarkullim brenda mureve të qytetit, paratë u bënë pjesë e identitetit të banorëve të tij. Kisha e Shasit i përkiste juridiksionit romano-katolik të cilit i përkiste kisha e saj në traditën komunale të cilën e ruajti brenda shteteve të reja në Arbërinë Veriore. Patroni ose mbrojtësi i qytetit ishte Shën Gjon Pagëzori, i plotësuar me mbishkrimin S IOHANES-B. Shën Gjoni Pagëzori paraqitet zbathur, me flokë dhe mjekër më të gjatë, me një nimbus, me një fustan, të mbuluar me një mantel të madh endje të theksuar, që përfundon me thekë. Në dorën e majtë mban një skeptër me një kryq të dyfishtë të mbështetur në shpatullën e tij, ndërsa dorën e djathtë është ngritur, me gishtin tregues të ngritur si gjest i atij që lë të kuptohet. Në anën e pasme të monedhës është një paraqitje e portës së qytetit e plotësuar me mbishkrimin SOVACII CIVITAS/ CIVITAS – SOVAON. Porta e qytetit është e hapur në bazën e saj me katër hapje gjysmërrethore, të ndara me shtylla me kapitela, dhe kolonada vazhdon në katin e parë, duke formuar dy harqe mbi të cilat ngrihen kulla me dhëmbëza sipër. Në lidhje me paraqitjet e fortesave, pra portave të qytetit të qyteteve bregdetare përreth Drishtit, Ulqinit dhe Kotorrit.

Shtojca:

Kalaja e Shasit. Planimetria Mr. Arkitekthe, K. Drançolli.



Shasi, qyteti i sipërm me mure. Foto NMCG, Arheološki muzej.



Mbetjet e kishës së Shën Mërisë. Foto NMCG, Arheološki muzej.



Shasi, Mbetjet e Katedrales së Shën Gjonit. Foto NMCG, Arheološki muzej.

Bibliografi:

Burime të botuara:

- *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*. Vol. 1. Collected and edited by Ludovicus de Thallóczy, Constantinus Jireček, and Emilianus de Sufflay. Vindobonae, 1913.
- Valentini, Giuseppe (Josephus). *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*. 25 vols. Palermo–Napoli–Roma–Venezia–München: Archivio di Stato di Venezia, 1967–72.
- *Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium. Commissiones et relations venetae*. Tom. 2 (annorum 1525–1553). Collected and edited by Simeon Ljubić. Vol. 8. Zagrabiae, 1877.

Monografi:

- Degrand, A. *Souvenirs de la Haute-Albanie*. Paris, 1901.
- Drançolli, Jahja. *Raguzanët në Kosovë*. Prishtinë: Instituti i Historisë, 1986.
- Drançolli, Jahja. “Kalaja e Shasit.” In *Shasi i lashtë, monument i kulturës*. Ulqin: OJQ “Ora”, 2009.
- Drançolli, Jahja. *Në Shas janë zbuluar edhe shenjat e kulturës ilire*. Ulqin: Buzuku, 2021.
- Istorija Crne Gore. Vol. 1, *Od najstarijih vremena do kraja XII vijeka*. Titograd: Redakcija za istoriju Crne Gore, 1967.
- Jireček, Konstantin. “Albanien in der Vergangenheit.” In *Illyrisch-Albanische Forschungen*, edited by L. von Thallóczy, vol. 1. Vienna, 1916.
- Korać, Vojislav. *Graditeljska škola Pomorja*. Beograd, 1965.
- Mijović, P., and M. Kovačević. *Gradovi, tvrđave u Crnoj Gori*. Beograd–Ulcinj, 1975.
- Shuflaj, Milan. *Qytetet dhe kështjellat e Shqipërisë: Kryesisht në mesjetë*. Edited by L. Malltezi. Tiranë: Onufri, 2009.

Artikuj shkencorë:

- Cameron, Averil, and James Pettifer. *The Enigma of Montenegrin History: The Example of Svač*. PDF. Accessed June 12, 2025.
- Ljubić, Simeon. “Izvjestaj barskoga nadbiskupa Marina Bizzia o svojem putovanju god. 1610 po Arbanaškoj i Staroj Srbiji.” *Starine* 20 (1888).
- Injac Zamputi (ed.), *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë veriore dhe të mesme në shekullin XVII*, vol. 1, 1610–1634. Tiranë, 1963.

- Zečević, E. “Rezultati istraživanja srednjovekovnog Svača.” *Glasnik Srpskog Arheološkog Društva* 5 (1989): 112–14.

Burime online:

- Marković, Savo. “Prošlost Svača.” Accessed March 29, 2025.

Jahja DRANÇOLLI

University of Pristina-Faculty of Philosophy

The Department of History

Email: jahja.drancolli@uni-pr.edu

ORCID: 0009-0004-1734-3947

KUD: 904:94(496.5-2)(05)

SUMMARY**SHASI, A WELL-KNOWN MEDIEVAL CENTER**

The medieval city of Shasi, whose origins reflect a deep continuity from Late Antiquity, occupied a strategically significant position atop the hill above Lake Shasi to the south and within the fertile expanse of the Buna delta to the north. Situated at a crossroads connecting Shkodra with Tivar and Ulqin, Shasi developed into a notable urban and ecclesiastical center embedded within wider medieval regional networks. Its urban structure comprised three distinct components. The Upper City, carved directly into the rocky hill above the lake, was strongly fortified with walls and a tower; yet, the primary northern entrance remained relatively exposed due to the gentle slope that facilitated access. The Lower Castle, positioned along this same incline, is believed to have relied on earthen fortifications. Meanwhile, the small southern gate offered passage toward the steep southern slopes descending sharply to the lake.

At the heart of Shasi's religious and communal life stood the principal church dedicated to Saint John the Baptist, the city's patron, whose courtyard inscription dates its construction to 1300. Surrounding ecclesiastical structures, including multiple suburban churches, were visually and symbolically dominated by the Romanesque-Gothic Church of the Virgin Mary. Archaeological and documentary evidence indicate continuous habitation from the sixth to the sixteenth century. The city's emergence is associated with the reign of Emperor Justinian, who initiated the construction of a network of smaller defensive installations safeguarding Shkodra, an important cultural and administrative center of the region.

Shasi appears in written sources as an episcopal seat as early as the eighth century. Its name, recorded as *Sas*, is first mentioned explicitly in a 1089

bull issued by Pope Clement III. The frequency with which Shasi appears in subsequent medieval documentation underscores its importance within the administrative framework of the Dioclean state. The city was incorporated into the Nemanjid realm between 1183 and 1186. It underwent significant reconstruction following Mongol incursions in 1242, a rebuilding phase attributed to the initiatives of Queen Helena of Anjou along the coastal territories. During the latter half of the fourteenth century, Shasi came under the authority of the Albanian Balsha dynasty. A letter from Bishop Peter Peter Kirten to the Venetian Signoria indicates that Shasi still preserved its strategic value, with its ecclesiastical authorities requesting assistance for further fortification. Nonetheless, documentary references from 1470 characterize Shasi merely as a village, and by 1553 it had been fully abandoned.

Evidence suggests that Shasi enjoyed a considerable degree of municipal autonomy, expressed through its urban statute and administrative structures documented between 1406 and 1485. The role of the local notary Pal Anxheli (Paul Angel) in consolidating the district's legal-administrative identity further reflects the city's institutional sophistication. Autonomy is also demonstrated by the minting of municipal coinage, whose iconography played a crucial role in shaping and disseminating the city's civic identity. The coins depict the "*face of the city*," symbolically reinforcing collective self-representation. These numismatic features circulated both within and beyond the fortified urban perimeter, embedding Shasi's identity into broader regional exchange networks.

Ecclesiastically, Shasi belonged to the Roman Catholic jurisdiction of the Northern Albanian diocesan landscape. Its patron saint, Saint John the Baptist (*S. Iohannes B.*), is represented on the city's coins barefoot, with long hair and beard, haloed, and dressed in a cloak of pronounced texture. In his left hand, he holds a scepter with a double cross, while the raised right index finger indicates a gesture of teaching or proclamation. The reverse of the coins depicts the city gates, marked with the inscriptions *SOVACII CIVITAS* or *CIVITAS SOVAON*. The gate iconography includes an open base with four semicircular arches supported by columnar structures, surmounted by a second tier of arches topped with crenellated towers. This visual program resonates with contemporary representations of fortifications and city gates in other Adriatic urban centers such as Drisht, Ulqin, and Kotor.

Overall, the archaeological, numismatic, and documentary record reveals Shasi as a dynamic medieval center whose fortifications, ecclesiastical institutions, and urban identity evolved in response to regional political shifts, external threats, and wider Adriatic cultural currents.